



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

Komuna e Kaçanikut

Opština Kaçanik/Municipality of Kaçanik



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Zyra e Kryetarit

Kaçanik, 15.05.2026

1	Data	15.05.2026	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.	Numri	Shtojcë	
		01-104/02-11372	/26	

Në bazë të Rregullores MF–Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe Ligjit Nr. 10/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, Komuna e Kaçanikut, përkatësisht Zyra e Kryetarit, shpall këtë:

THIRRJE PUBLIKE

për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve

1. Qëllimi i thirrjes publike

Kjo thirrje publike ka për qëllim mbështetjen financiare publike të projekteve/programeve të organizatave joqeveritare që trajtojnë njëri ose më shumë nga fushat që lidhen me mbrojtjen e ambientit/mjedisit, ndërgjegjësimin e qytetarëve për ruajtjen e mjedisit, përmirësimin e hapësirave publike, promovimin e praktikave të gjelbra, si dhe ndërmarrjen e aktiviteteve konkrete që ndikojnë në krijimin e një ambienti më të pastër, më të shëndetshëm dhe më të qëndrueshëm për qytetarët e Komunës së Kaçanikut.

2. Organizatat që ftohen të aplikojnë

Komuna e Kaçanikut – Zyra e Kryetarit, duke u bazuar në Rregulloren MF–Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, fton të gjitha organizatat joqeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, me bazë në Komunën e Kaçanikut, për aplikim për mbështetje financiare publike – subvencionim të projekteve/programeve të tyre, programi i punës i të cilave është i fokusuar në mbrojtjen e ambientit/mjedisit, ngritjen e vetëdijes qytetare dhe ndërmarrjen e veprimeve konkrete në funksion të ruajtjes dhe përmirësimit të mjedisit.

3. Fushat dhe aktivitetet që mund të mbështeten

OJQ-të, në përputhje me këtë thirrje publike, mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre, të cilat duhet të kenë për objekt zbatimin e aktiviteteve të ndryshme në fushën e mbrojtjes së ambientit/mjedisit.

Mbrojtja e ambientit/mjedisit përfshin, por nuk kufizohet vetëm në:

- ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ambientit në hapësirat publike;
- mbrojtjen e natyrës, pyjeve, lumenjve, burimeve ujore dhe hapësirave rekreative;
- promovimin e menaxhimit të drejtë të mbeturinave dhe ndarjes së tyre;
- aktivitete për riciklim, ripërdorim dhe zvogëlim të mbeturinave;
- mbjelljen e drunjve, luleve dhe gjelbërimin e hapësirave publike;
- ndërgjegjësimin e qytetarëve për ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës;
- edukimin mjedisor të nxënësve, të rinjve dhe komunitetit;
- aktivitete sensibilizuese kundër hedhjes së mbeturinave në vende të palejuara;
- aktivitete që nxisin pjesëmarrjen e qytetarëve, të rinjve, shkollave dhe komunitetit në mbrojtjen e ambientit.

Aktivitetet e pranueshme mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

- organizimin e aksioneve për pastrimin e hapësirave publike;
- organizimin e fushatave sensibilizuese për ruajtjen e ambientit;
- aktivitete edukative në shkolla dhe komunitet për mbrojtjen e mjedisit;
- mbjelljen e drunjve dhe gjelbërimin e hapësirave publike;
- vendosjen e materialeve informuese dhe ndërgjegjësuere për mbrojtjen e ambientit;
- aktivitete për promovimin e riciklimit dhe menaxhimit të mbeturinave;
- punëtori, ligjëratat, tryeza dhe aktivitete publike me temë mjedisore;
- aktivitete që ndikojnë në përfshirjen e qytetarëve në mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike;
- bashkëpunim me shkolla, komunitete lokale dhe institucione publike për zbatimin e aktiviteteve mjedisore.

4. Vlera e mbështetjes financiare

Vlera totale e planifikuar e kësaj thirrjeje publike është 5,000.00 €.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 1,000.00 €, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 5,000.00 €.

Komuna e Kaçanikut – Zyra e Kryetarit rezervon të drejtën që, varësisht nga cilësia e aplikimeve dhe buxheti në dispozicion, të mbështesë një ose më shumë projekte/programe.

5. Afati për dorëzimin e aplikacioneve

Afati për dorëzimin e propozimeve/aplikacioneve është 15 ditë pune, duke filluar nga data 15.05.2026 dhe përfundon më datën 05.06.2026, deri në ora 16:00.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të përcaktuar me këtë thirrje publike nuk do të merren në shqyrtim.

6. Kushtet për aplikim

Të drejtë aplikimi me projektet/programet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku një (1) vit para datës së publikimit të kësaj thirrjeje publike.

OJQ-të duhet të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente, sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-ja duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

Nuk do të mbështeten projekte/programe që kanë karakter politik apo partiak, që paraqesin financim të dyfishtë për të njëjtat aktivitete, apo që bien ndesh me legjislacionin në fuqi dhe me qëllimin e kësaj thirrjeje publike.

7. Dokumentacioni dhe mënyra e aplikimit

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilët janë në dispozicion në faqen zyrtare të Komunës së Kaçanikut:

<https://kacanik.rks-gov.net/shpalljet/>

(rubrika: SHPALLJET)

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen fizikisht në objektin e Komunës së Kaçanikut, te sporteli nr. 8, kati i parë, në zarf të mbyllur, me mbishkrimin:

“Aplikim për mbështetje financiare publike për OJQ – Zyra e Kryetarit”

- Të mos hapet para mbledhjes së Komisionit Vlerësues -

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet/programet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara në thirrje dhe në dokumentacionin përcjellës të saj.

8. Vlerësimi, kontraktimi dhe raportimi

Vlerësimi i aplikacioneve do të bëhet nga Komisioni Vlerësues i themeluar nga Komuna e Kaçanikut, në përputhje me Rregulloren MF-Nr. 04/2017 dhe dokumentacionin e kësaj thirrjeje publike.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, rezultatet do të publikohen në faqen zyrtare të Komunës së Kaçanikut. OJQ-të përfituese do të lidhin kontratë me Komunën e Kaçanikut dhe janë të obliguara që mjetet e ndara t'i shfrytëzojnë vetëm për qëllimet e mirat dorëzojnë raport narrativ dhe financiar pas përfundimit të projektit/programit.

Sabedin Vishi

